



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 909/7 prot.

Tiranë më 6.7.2018

VENDIM

Nr. 30, datë 6.7.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Z. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 909 Prot., datë 21.05.2018, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Avokaturës së Shtetit" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës së datës 26.04.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t'i vihet në dispozicion dokumentacioni dhe informacioni i disponueshëm në lidhje me:

- 1. Nga viti 2005 deri në vitin 2018, sa thirrje publike për interes (prokurime publike) janë publikuar nga ana e Avokaturës së Shtetit për firma të huaja dhe vendase për përfaqësim të Republikës së Shqipërisë në procedura arbitrazhi ndërkombëtar ku kjo e fundit ka qënë palë?*

2. Nga viti 2005 deri në vitin 2018, sa prokurime direkte (pa thirrje të hapur për interesim) janë kryer nga Avokatura e Shtetit në fushën e përfaqësimit në arbitrazhin ndërkombëtar, dhe për cilat raste dhe cilat arsye?
3. Cili ligj dhe akte nënligjore janë përdorur nga Avokatura e Shtetit si bazë ligjore për të rregulluar procedurat e prokurimit të studiove për përfaqësim të Republikës së Shqipërisë në arbitrazh ndërkombëtar?
4. Cilat janë firmat e huaja dhe vendase të cilat kanë shfaqur interes në pjesëmarrje në procedurat e përzgjedhjes së studiove ligjore për përfaqësim të Republikës së Shqipërisë në arbitrazh ndërkombëtar?
5. Një kopje të thirrjeve publike për interes të shpallura për periudhën 2005-2018.
6. Për secilën nga këto procedura prokurimi publik, një kopje të dokumentave të cilat parashikojnë elementet dhe kushtet e vlerësimit të firmave të ndryshme për përfaqësim potencial.
7. Për secilën nga këto procedura prokurimi publik, një kopje të CV-ve të firmave aplikuese për thirrjen publike për interesim.
8. Për secilën nga këto procedura prokurimi publik, një kopje të vlerësimit të kryer nga Avokatura e Shtetit për secilën firmë pjesëmarrëse në prokurim.
9. Për secilën nga këto procedura prokurimi publik, një kopje të vlerësimit dhe arsyetimit të Avokaturës së Shtetit për firmën fituese të prokurimit.

Autoriteti Publik, me e-mail të datës 21.05.2018 i ka kthyer përgjigje pjesërisht kërkuarit vetëm për pikat 1, 3 dhe 5 të kërkesës. Në lidhje me pikat 2, 4, 6, 7, 8 dhe 9 është refuzuar vënia në dispozicion dokumentacionit të kërkuar duke argumentuar se: *"Informacioni i kërkuar lidhet me arbitrazhin ndërkombëtar dhe ky proces karakterizohet nga konfidencialiteti në të gjithë ecurinë e vet, duke përfshirë por pa u kufizuar, palët, ekspertët, dëshmitarët, konsulentët, avokatët përfaqësues dhe çdo palë të tretë të lidhur direkt apo indirekt me palët ndërgjyqëse, mosmarrëveshjet, elementët procedural dhe material të çështjes si edhe çdo informacion/dokumentacion lidhur me pretendimet dhe prapësimet përkatëse, informacioni dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk mund t'iu sigurohet... Sigurimi i informacionit (të plotë) të kërkuar do të shkaktonte cenim të konsiderueshëm të interesit të barazisë së palëve në proces gjyqësor dhe mbarëvajtjes së procesit gjyqësor dhe të konfidencialitetit të të gjithë procedurave që lidhen me gjykimet në arbitrazh...".*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka vijuar ankimin me nr. 909/1 Prot., datë 28.05.2018 pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, me shkresën nr. 909/2 Prot., datë 01.06.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik rivlerësimin e dhënies së informacionit brenda datës 08.06.2018.

Me shkresën nr. 909/3 Prot., datë 11.06.2018, Autoriteti Publik ka rivlerësuar kërkesën, duke sqaruar se: *"- Në lidhje me pikën 2 të kërkesës, Avokatura e Shtetit nuk ka bërë asnjë*

procedurë konkurimi të drejtëpërdrejtë për kontraktimin e zyrave të avokatisë apo avokatëve me profesion të lirë për të na përfaqësuar në proceset e arbitrazhit. - Në lidhje me pikën 6 të kërkesës, këto kriteret janë të përcaktuara në akte ligjore që tashmë jua kemi vënë në dispozicion. Konkretisht në nenin 13 të VKM Nr.392, datë 08.04.2009 "Për miratimin e rregullores...", parashikohen kriteret që përdor Avokatura e Shtetit për të vlerësuar ofertat që paraqiten në një procedurë konkurimi. - Në lidhje me pikat e tjera (4, 7, 8 dhe 9), informacioni i kërkuar është konfidencial, prek sekretin tregëtar dhe marrëdhëniet e besimit avokat klient".

Në ndjekje të procedurës, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se "Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", me shkresën nr. 909/6 Prot., datë 20.06.2018, Komisioneri ftoi palët në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me praninë e ankuesit Z. dhe personit të autorizuar nga njëra anë dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik nga ana tjetër.

Gjatë seancës, pala ankuese dhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër. Gjithashtu, ankuesi ngriti dhe pretendimin se informacioni i dhënë në lidhje me pikat 1 dhe 5 të kërkesës nuk është i plotë, pasi mungon informacioni në lidhje me procedurat e arbitrazhit përpara vitit 2015.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë.

Në lidhje me pikat 1 dhe 5 të kërkesës, Autoriteti Publik pretendon se informacioni është vënë në dispozicion të kërkuarit duke deklaruar se "Ankuesi është informuar mbi numrin e procedurave të konkurimit që janë bërë nga ana e Avokaturës së Shtetit në lidhje me proceset e arbitrazhit. Pas ristrukturimit dhe hyrjes në fuqi të VKM-së Nr. 392/2009, janë përcaktuar dhe kompetencat e Avokaturës së Shtetit për të zhvilluar procedura kontraktimi në lidhje me marrjen e avokatëve apo studiove të huaja. Kjo do të thotë se Avokatura nuk disponon informacion para vitit 2009".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit Komisioneri vëren se kërkuarit i janë vënë në dispozicion vetëm procedurat e arbitrazhit ndërkombëtar pas vitit 2015. Nga ana e Autoritetit Publik nuk është argumentuar nëse disponohet apo jo informacion për vitet 2009 e në vazhdim, por është cituar vetëm baza ligjore e cila i jep tagrin dhe detyrimin ligjor për organizimin e procedurave të arbitrazhit ndërkombëtar pas këtij viti. Në këto kushte, nëse Autoriteti Publik disponon informacion për periudhën 2009 – 2015, ai i duhet vënë në dispozicion kërkuarit.

Në lidhje me pikën 2 të kërkesës, Autoriteti Publik ka sqaruar se: "Nuk është bërë asnjë procedurë konkurimi të drejtëpërdrejtë për kontraktimin e zyrave të avokatisë apo avokatëve me profesion të lirë për të përfaqësuar Avokaturën e Shtetit në proceset e

arbitrazhit". Për sa më lart, rezulton se Autoriteti Publik nuk e disponon informacionin e kërkuar.

Në lidhje me pikën 3 të kërkesës, rezulton se, Autoriteti Publik ka përmbushur detyrimin për dhënie informacioni.

Në lidhje me pikën 6 të kërkesës, Autoriteti Publik pretendon se informacioni është vënë në dispozicion të kërkuarit duke argumentuar se: *"Kriteret janë të përcaktuara në akte ligjore që tashmë janë vënë në dispozicion. Konkretisht në nenin 13 të VKM Nr.392, datë 08.04.2009 "Për miratimin e rregullores...", parashikohen kriteret që përdor Avokatura e Shtetit për të vlerësuar ofertat që paraqiten në një procedurë konkurimi". Ky pretendim i Autoritetit Publik nuk qëndron pasi kërkuarit, në kundërshtim me objektin e kërkesës i është vënë në dispozicion vetëm baza ligjore në të cilën parashikohen kriteret e përgjithshme për vlerësimin e ofertave që paraqiten në një procedurë kontraktimi dhe jo një kopje e dokumenteve të cilat parashikojnë elementet dhe kushtet e vlerësimit të firmave të ndryshme për përfaqësim.*

Bazuar në pikën 3 të nenit 19 të VKM-së së sipërcituar, Autoriteti Publik për çdo procedurë harton "Ftesën për Negociata", e cila duhet të përmbajë *"specifikimin e objektit dhe llojit të shërbimit të kërkuar, nevojën e kontraktimit të avokatëve/zyrave të avokatisë në profesion të lirë, kriteret e përgjithshme e të veçanta që duhet të plotësohen nga avokatët apo zyrat e avokatisë, dhe datën përfundimtare të pranimit të kërkesës nga të interesuarit". Gjithashtu bazuar në nenin e sipërcituar Autoriteti Publik ka detyrimin të bëjë publike "Ftesën për negociata" edhe në faqen zyrtare të organit të administratës publike apo entit publik. Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se ky informacion/dokument zotërohet nga Autoriteti Publik dhe si i tillë përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", rrjedhimisht i duhet vënë në dispozicion kërkuarit.*

Autoriteti Publik, ka refuzuar vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në lidhje me pikat 4, 7, 8 dhe 9 të kërkesës duke argumentuar ndër të tjera se: *"Informacioni i kërkuar është konfidencial, prek sekretin tregtar dhe marrëdhëniet e besimit avokat klient. Konkretisht ofertat e paraqitura nga avokatët janë komunikuar me mbishkrimin konfidencial. Bazuar kjo në nenin 8 të KPr Administrative ku parashikohet se: "Pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre personale dhe konfidenciale të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi". Gjithashtu raportet e vlerësimit që bën Avokatura e Shtetit në lidhje me ofertat e paraqitura është e pamundur të bëhen publike pasi përmbajnë sekret tregtar të avokatëve. Parimet e shpjeguara dhe më sipër gjenden edhe në Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i cili në nenin 17 njeh parimin e mbrojtjes së konfidencialitetit të të dhënave që përbëjnë sekret tregëtar, duke i garantuar institucionit të drejtën për të mos bërë publike të dhëna të cilat mund të çenojnë sekretin tregëtar të palëve të përfshira në një procedurë administrative.*

Në rastin konkret gjejnë vend gjithashtu dhe parimet e konfidencialitetit në marrëdhëniet avokat – klient. Pavarësisht se Avokatura e Shtetit është një institucion publik, funksioni

i saj i vetëm është ushtrimi i së drejtës së mbrojtjes ndaj shtetit shqiptar e konkretisht avokatit. Bëhet një dallim mes mbrojtjes që zhvillon një institucion mes grupit të vetë juristëve dhe mbrojtjes që zhvillon një institucion mes grupit të vetë të juristëve dhe mbrojtjes që bën Avokatura e Shtetit si institucion qëndror që mbron interesat pasurore të shtetit. Në këtë kuptim marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet e tjera, apo palët private të përfshira në një procedurë administrative në lidhje me përfaqësim mbrohen nga parimi i konfidencialitetit "avokat – klient", këto bazuar në nenin 9/3 të Ligjit nr. 9109, datë 17.07.2003 "Për profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe detajuar më tepër në Kodin Etik i Avokatit miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Sa më sipër, përtej vullnetit të Avokaturës së Shtetit për të ndarë informacion me publikun, për shkak të natyrës së veçantë të punës, e ka të pamundur të ndaj me publikun informacione specifike që kanë të bëjnë me procedura administrative apo procedura gjyqësore."

Komisioneri vlerëson se arsyetimi i bërë nga Autoriteti Publik për refuzimin e kërkesave të sipërcituara është i gabuar, pasi Autoriteti Publik nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë të asaj që lejohet të bëhet publike ose jo.

Konkretisht për pikat 4 dhe 7 të kërkesës, nga ana e Autoritetit Publik janë cituar dispozita të përgjithshme ligjore që kanë të bëjnë me konfidencialitetin, sekretin tregtar apo marrëdhëniet e besimit avokat klient, por nuk është argumentuar saktësisht se si dhënia e këtij informacioni mund të çënojë apo shkelë këto parime. Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative të cituara nga Autoritetit Publik lidhur me konfidencialitetin e firmave të huaja dhe vendase të cilat kanë shfaqur interes në pjesëmarrje, nuk gjejnë zbatim, pasi duke qenë avokatët/firmat avokatore subjekte tregtare, të dhënat e tyre nuk klasifikohen si të dhëna personale në kuptim të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Në bazë të nenit 3, pika 1 e ligjit të sipërcituar, parashikohet se: "*E dhënë personale*" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social".

Gjithashtu referuar për analogji edhe nenit 25 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, ku ndër të tjera citohet se: "*...informacioni konfidencial lidhur me ofertat përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave*", rezulton se jo e gjithë informacioni i përfshirë në ofertat e paraqitura nga avokatët/firmat avokatore mund të klasifikohet si informacion konfidencial.

Sa i përket argumentit lidhur me sekretin tregtar, pika 2 e nenit 18 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar parashikon se: "*Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkëlqen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik*".

Për sa i përket pikave 8 dhe 9 të kërkesës, neni 19 pika 6 e VKM-së 392, datë 8.4.2009 "Për miratimin e rregullores "Për marrëdhëniet e avokaturës së shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale", përcakton se: "Brenda 2 ditëve nga përfundimi i procedurës së përzgjedhjes, komisioni harton një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, avokatët/zyrat e avokatisë që kanë marrë pjesë dhe avokatin/ zyrën e avokatisë së përzgjedhur, të cilin ia paraqet Ministrit të Drejtësisë, së bashku me klasifikimin përfundimtar të avokatëve/zyrave të avokatisë sipas pikëve. Ky raport i njoftohet njëkohësisht avokatëve/zyrave të avokatisë që kanë marrë pjesë, si dhe organit shtetëror që kërkon kontraktimin". Sa më sipër rezulton se informacioni i kërkuar në këto dy pika të objektit të kërkesës është prodhuar dhe administrohet nga Autoriteti Publik, dhe si i tillë përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Në frymën e nenit 17 pika 6 e ligjit të sipërcituar, sipas të cilit "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim", Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik, duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të raportit të vlerësimit të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër, duke vënë në dispozicion të kërkuarit pjesën tjetër të tij.

Gjithashtu, lidhur me argumentin e dhënë nga Autoriteti Publik se dhënia e informacionit ndalohet sipas nenit 9, pika 3 e Ligjit nr. 9109 datë 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Komisioneri konstaton se ligji i sipërcituar rregullon profesionin e avokatisë si profesion i lirë, i pavarur, i vetërregulluar dhe i vetëdrejtuar ndërsa avokati i shtetit është nëpunës civil dhe parimet e veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit janë të cituara në nenin 3 të Ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit".

Për më tepër asnjë nga elementët që karakterizojnë profesionin e avokatisë si profesion i lirë nuk mund t'i vishet rolit të Avokaturës së Shtetit e cila, bazuar në pikën 1 të nenit 2 të Ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" është institucioni qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike për institucionet shtetërore dhe entet publike. Bazuar në këtë përcaktim, Avokatura e Shtetit klasifikohet si Autoritet Publik në kuptim të nenit 2, pika 1 e Ligjit për të Drejtën e Informimit dhe rrjedhimisht nuk mund të refuzojë vënien në dispozicion të dokumenteve dhe informacioneve që ajo administron apo prodhon në kuadër të përmbushjes së detyrave të saj publike.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i çështjes rezulton se informacioni i kërkuar nga Z.

në pikat 1, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të kërkesës është i regjistruar pranë Autoritetit Publik dhe si i tillë administrohet prej tij duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me pikat 1, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të ankesës së Z. _____ ndaj Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është bazuar në ligj dhe si i tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mos marrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës Nr. 909 Prot., datë 21.05.2018 të Z. _____, ndaj Autoritetit Publik “Avokatura e Shtetit”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikat 1, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 të kërkesës datë 26.04.2018, brenda datës 18 . 7 .2018.
3. Rrëzimin e ankesës për dokumentacionin e kërkuar në pikat 2 dhe 3 të kërkesës për informacion datë 26.04.2018.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Ky vendim u dha shpall sot në datë 6 . 7 .2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

